

15.09.2018

C.nr.22/16



GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Civil, me gjyqtarin Misin Frangu dhe zyrtaren ligjore Albana Ajvazi, në çështjen juridike-kontestimore, sipas padisë së paditësit [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED] nr. [REDACTED] kontestimor, t'i konsideron se [REDACTED] avokat nga Ferizaj, kundër të paditures të cilin me autorizim e përfaqëson [REDACTED] për shkak të kompensimit Komuna Ferizaj, e përfaqësuar me autorizim nga [REDACTED], për shkak të kompensimit të dëmit material, në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 20.08.2018, merr ketë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht, kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga Ferizaj dhe DETYROHET e paditura Komuna Ferizaj, që në emër të shpërblimit të dëmit material, t'ia paguajë paditësit shumë prej 165.00 € (njëqindëgjashtëdhjetëepesëeuro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.

II. REFUZOHET pjesa tjeter e kërkesëpadisë së paditësit, e këruar përtej shumës së aprovar si në paragrafin (I) të dispozitivit, dhe atë shuma prej 680.00 €, si e pabazuar.

III. Secila palë i heqë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m i

Paditësi [REDACTED] nga Ferizaj, me datën 14.01.2016 ka paraqitur padi kundër të paditures Komuna Ferizaj, për kompensimin e dëmit material.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në muajin korrik 2014 me organizim të Galerisë së Arteve në Ferizaj ka udhëtar në Francë për një ekspositë arti, nga ku paditësi është paraqitur me disa pikturne. Sipas rregullave të organizimit, e paditura ka qenë e obliguar t'i dërgojë pikturnat në ekspositë në Francë dhe që t'i kthejë të njejtat prapë në Kosovë pas përfundimit të ekspositës. Mirëpo, e paditura, me rastin e kthimit të pikturnave në Kosovë, paditësit i'a ka humbur dy pikturne, të cilat paditësi deklaron se të njejtat vleinë në shumë prej 850 €, të cilën shumë tanë kërkon që t'i kompensohet nga e paditura. Lidhur me pretendimet e palës së paditur se vlera reale e pikturnave të humbura është 80 euro për njëren dhe 85 euro për tjetrën pikture, ashtu siç edhe është caktuar vlera reale në listën e punimeve për ekspositë, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaron se ky çmim është vendosur shumë i ulët vetëm përsye të kalimit doganor gjatë udhëtimit për në Francë, dhe aspak nuk paraqet vlerën reale të veprave të tij të humbura. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaron se nuk i kërkon shpenzimet e përfaqësimit.

Përfaqësuesi i autorizuar i palës së paditur ka deklaruar se e kontestojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke mbetur pranë theksimeve në seancat e mbajtura pranë kësaj gjykate, dhe njëherit e kundërshtojmë vlerën e pretenduar nga paditësi, ngase sipas listës së veprave të prezantuara në ekspositë, veprat artistike "natyrë e qetë" është vlerësuar në shumë prej 80 euro, ndërsa vepra tjetër "natyrë e vdekur" është vlerësuar në shumë prej 85 euro. Përfaqësuesi i autorizuar i të paditures poashtu ka deklaruar se e kundërshton bazën juridike të kërkesëpadisë, ngase e paditura nuk ka qenë organizatore e vizitës por vetëm si mbështetëse e saj dhe njëherit i kundërshton thëniet e dëshmitarëve të dhëna në cilësi të dëshmitarëve, si jo reale.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqjëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si vijon: *formulari për kërkesë/ ankesë i dt. 27.01.2015 me nr. protokolli 08-422-7718; kërkesa drejtuar Galerisë së Arteve në Ferizaj i dt. 27.01.2015; fotografitë e punimeve artistike të paditësit [REDACTED] lista e punimeve që do të eksposohen në Galerinë e Arteve Art – Vilamagna në Francë; raporti i transportit "Mecatyp – KS" Sh.p.k.; fatura në gjuhën frëngje e dt. 12.08.2014 me nr. reference 146.31.0369.00; fatura nga adresa e dërgesës dhe në adresën e destinuar në Ferizaj me nr. 0601551; dhe konfirmimi i dt. 08.04.2014*

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 parg.1 dhe 2 të LPK-së, ka gjetur se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dëshmitari [REDACTED] i lindur më dt. [REDACTED] në Prishtinë, ka deklaruar se është udhëheqës i Galerisë së Arteve në Ferizaj dhe në ekspositën në fjalë edhe ai i ka prezantuar disa punime artistike të ngjashme, të cilat kanë vlerë mesatare prej 100 euro për një pikturë. Mëtej dëshmitari deklaron se Galeria e Arteve në Ferizaj nuk ka qenë organizatore e vizitës, por vetëm koordinatore e saj, me ç'rast si institucion i artit, i ka grumbulluar të gjitha punimet dhe e ka përpiluar listën e punimeve për ekspositë. Njëherit Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Ferizaj e ka bërë financimin e biletave të udhëtimit për pjesëmarrësit e ekspositës, gjithashtu gjatë vizitës në Francë, për këtë ekspositë, ka marrë pjesë edhe kryetari i atëhershëm i Komunës së Ferizaj, [REDACTED] Drejtori për Kulturë, Rini dhe Sport [REDACTED] Konsulli i atëhershëm i Kosovësi cili vepron në Zvicër si dhe zëvendës ministri i atëhershëm [REDACTED] Sipas dëshmitarit, e gjithë kjo është bërë me qëllim që të prezanton hemi si shtet në këtë ekspositë në Francë, e jo në mënyrë individuale.

Dëshmitari ekspert, piktor [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], K. Ferizaj, pas shiqimit të fotografive të veprave të humbura, ka deklaruar se një punim i tillë, si këto veprat e humbura në Kosovë mund të kushtojë së paku 500 euro. Sa i përket përgjegjësisë për pikurat e humbura, dëshmitari deklaron se ai ka marrë pjesë në shumë eksposita gjatë karrierës së tij artistike, dhe gjithëherë në organizime të tilla, përgjegjësinë për bartjen veprave artistike e ka bartur organizatori.

Gjykata, nga deklarimi i dëshmitarit [REDACTED] ka kuptuar se vizita për të marrur pjesë në ekspozitë në Francë, sa do që është inicuar nga individë të caktuar privatë, ajo prapë se prapë ka marrë karakter shtetëror, e sidomos me financimin e udhëtimit nga Komuna e Ferizajt, dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Komunës e të institucioneve tjera qendrore të Kosovës. Për më tepër, e paditura ashtu siç e ka bërë grumbullimin e pikturave para nisjes për në Francë, ashtu ka qenë dashur që të kujdesej për kthimin e tyre në Kosovë pas përfundimit të ekspositës.

Dëshmisë së Dëshmitarit [REDACTED] gjykata nuk i'a fali besimin, sepse dëshmitari ka bërë vlerësimin e pikturave të humbura me hamendësime dhe i njejtë nuk ka dhënë asnje shpjegim profesional lidhur vlerësimin e tij.

Andaj, Gjykata konsideron se ekzistojnë prova të besueshme, që provojnë se janë plotësuar të gjitha elementet e ekzistimit të dëmit material, të shkaktuar nga pakujdesia e të paditures, si dhe ekzistimin e përgjegjësisë te e paditura, e cila është e obliguar që mbi bazën e dispozitave të LMD-së, paditësit t'ia shpërblejë dëmin e shkaktuar.

Me rastin e përcaktimit të vlerës së veprave artistike të humbura, gjegjësish me rastin e caktimi të lartësisë së kompensimit në këtë procedurë, Gjykata ka marrë për bazë Listën me shkrim, në të cilën janë të shënuara veprat artistike pjesëmarrëse në ekspozitë, si dhe çmimet e përcaktuar në këtë listë për secilën vepër artistike, pëfshirë edhe dy veprat artistike të humbura.

Gjykata thekson se provat tjera të administruara në këtë procedurë lidhen me konstestin në fjalë, mirëpo nuk e ka pa të nevojshme të shtjellohen pasi që të njejtat nuk e përcaktojnë vlerën e pikturave të humbura e as përgjegjësinë e ndonjë pale të caktuar për shkaktimin e dëmit.

Nga arsyet e lartëcekura, konform neneve 136, 169 dhe 170 të LMD-së, dhe neneve 2, 143 dhe 323 të LPK-së, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Për shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C.nr.22/16 dt. 20.08.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JË PRAVNO-SNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më
Dana

22 10 20 18



KËSHILJA JURIDIKË: Këndër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij së tige në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

